

VENDIM
Nr. 220, datë 17.4.2025

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIM DEPO NË ZONËN E KODËR-KAMZËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Ndërtim depo në zonën e Kodër-Kamzës”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 34 891 230 (tridhjetë e katër milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e tridhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 34 891 230 (tridhjetë e katër milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e tridhjetë) lekësh përballohet nga Ujësjellës-Kanalizimet Tiranë sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Ujësjellës-Kanalizimet Tiranë sh.a.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Ujësjellës-Kanalizimeve Tiranë sh.a.

8. Ujësjellës-Kanalizime Tiranë sh.a., kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Ujësjellës-Kanalizimet Tiranë sh.a.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Bashkisë Tiranë, për Ujësjellës-Kanalizimet Tiranë sh.a., sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Bashkisë Tiranë, për Ujësjellës-Kanalizimet Tiranë sh.a., sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ujësjellës-Kanalizimet Tiranë sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES
PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTT "NDËRTIM DEPO NË ZONËN E KODËR-KAMZË"

TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)																VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				SHËNIME (Kufizime hipotekare, barri mbi pasuritë etj.)
NR.	PRONARI	Fshati ose qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Sip.shpron.(m²)	Sip.pjeses takuese	Volumi	Faqe	"TRUALL"			VLERA TOTALE (lekë)						
											Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)							
	A	C	C	D	E	F			I	K	O	P	Q	Y	Z					
1	Lirije Ahmet Fortuzi	Tiranë	8320	7/440	Truall	7000	1518		21	54	1518	22985	34 891 230	34 891 230						
	Artan Agim Pema																			
	Ikbale Qazim Pema																			
	Fatos Haki Pema																			
	Halil Mehmet Vorpsi																			
	Arben Mehmet Vorpsi																			
	Lumnie Mehmet Xhako																			
	Suzana Mehmet Xhetani																			
	Emine Haki Steaj																			
	Irma Haki Canameri																			
	Vesime Haki Xhaxhiu																			
	Mukades Mustafa Pema																			
	Klajdi Bardhyl Pema Alma																			
	Agim Taraku																			
	Qemal Murat Deliallisi																			
Nexhmie Ramazan Deliallisi																				
Dhurata Ahmet Mato																				
Elda Hasan Pema																				
Endrit Hasan Pema																				
Enela Hasan Pema																				
Sefer Ahmet Pema																				
Qaniye Haki Bakalli																				
Myzejen Bardhyl Pema																				
Mirela Sulejman Pema																				
Flavia Kujtim Pema																				
Ajxel Kujtim Pema																				
Anila Bardhyl Shaba																				
Myzejen Ahmet Kaçuku																				
VLERA TOTALE												1518.0	22985	34 891 230	34 891 230					